



# Angazhohu!

**Liga Mannerheim për Mirëqenien e  
Fëmijës**



MANNERHEIMIN  
LASTENSUOJELUJON  
*Lapin piiri*

**LAPSET ENSIN**

## Liga Mannerheim për Mirëqenien e Fëmijës

- është një organizatë joqeveritare e themeluar në vitin 1920
- Punon për të promovuar mirëqenien e fëmijëve, të rinjve dhe familjeve me fëmijë
- Vepron në të gjithë Finlandën
- Nuk ka përkatësi politike apo fetare

## Liga Mannerheim për Mirëqenien e Fëmijës

- Një organizatë qendrore e shtrirë në mbarë vendin
- 10 organizata në nivel qarku
- 588 shoqata lokale
- Më shumë se 91 000 anëtarë

### Vlerat e MLL

- Vlerësimi i fëmijëve dhe i moshës së fëmijërisë
- Ndarja e një përgjegjësie të përbashkët
- Humanizmi
- Barazia

### Parimet e MLL

- Transparenca
- Gëzimi
- Shoqërimi dhe miqësia
- Pjesëmarrja
- Vlerësimi i të përditshmes



# Aktivitetet dhe shërbimet për familjet dhe fëmijët

## Kafenetë familjare

Kafenetë familjare të MLL u mundësojnë prindërve të fëmijëve të vegjël një vend ku ata mund të takojnë prindërit e tjerë dhe të ndajnë përvojat e tyre. Fëmijët mund ta shfrytëzojnë këtë mundësi për të luajtur me fëmijët e tjerë. Kafenetë familjare përdoren për të biseduar, pranë një filxhani kafeje ose çaji, duke luajtur me fëmijët. Ato gjithashtu janë vendet ku organizohen prezantime nga ekspertët e fushës. Aktivitetet drejtohen nga instruktorë vullnetarë. Kafenetë familjare mirëpresin të gjitha familjet me fëmijë! Edhe ju gjithashtu mund të angazhoheni e të bëheni edhe vetë një instruktor i Kafenesë familjare.

## Klubet

MLL drejton një gamë klubesh të ndryshme për fëmijët dhe familjet. Në këto klube, fëmijët merren me gjërat që u pëlqejnë dhe u interesojnë, dhe ata lejohen të luajnë, të eksplorojnë dhe të mësojnë sipas hapit të tyre.

Atmosfera që ekziston në këto klube i ndihmon ata të zënë miq të rinj dhe njëkohësisht i mëson ata se si të përshtaten e të kalojnë mirë me të tjerët..

MLL i mirëpret të gjithë fëmijët në klube!

Edhe ju gjithashtu mund të angazhoheni e të bëheni edhe vetë një instruktor klubi.






## Vullnetarë në mbështetje të familjeve

MLL trajnon vullnetarë për të vepruar si persona mbështetës për familjet me fëmijë. Vullnetarët që veprojnë si mbështetës për familjet ofrojnë ndihmë dhe mbështetje për aspekte të ndryshme të jetës familjare, duke dhënë këshilla lidhur me punën si prindër e duke i ndihmuar prindërit që të përballojnë jetën e përditshme.

Vullnetarët që veprojnë në mbështetje të familjeve janë të disponueshëm për familjet me një apo më shumë fëmijë në moshë parashkollore dhe për familjet ku nëna është shtatzënë. Edhe ju gjithashtu mund të angazhoheni e të trajnoheni për t'u bërë edhe vetë një vullnetar në mbështetje të familjeve.



## Aktivitetet baba-fëmijë

Aktivitetet baba-fëmijë janë konceptuar për të mbështetur figurën atërore dhe për të forcuar ndërveprimin ndërmjet baballarëve dhe fëmijëve të tyre. Aktivitetet përfshijnë klube, kampe baba-fëmijë, seanca grupi mes shokësh dhe lloje të ndryshme evenimentesh.

Të gjithë baballarët janë të mirëpritur!  
Edhe ju gjithashtu mund të angazhoheni e të trajnoheni për t'u bërë një instruktur për grupin e baballarëve.





## Aktivitetet për prindërit

### Grupet e të barabartëve

Grupet e të barabartëve janë krijuar për të mundësuar takime me prindërit e tjerë që ndajnë situata të ngjashme të jetës. Ato krijojnë një mundësi për të ndarë përvojat personale dhe ndjenjat e tyre me prindërit e tjerë.

Grupet e të barabartëve gjithmonë drejtohen nga një instruktor. Ka grupe të veçanta për familjet që janë bërë prindër për herë të parë dhe prindërit e fëmijëve të moshës delikate që karakterizohet nga shpërthime zemërimi të çastit si dhe shumë grupe të tjera.

Të gjithë prindërit janë të mirëpritur!

Edhe ju vetë gjithashtu mund të angazhoheni dhe të bëheni një instruktor grupi të barabartësh.

### **Bëhuni mbështetësja miqësore e një nëne emigrante**

Skema "Bëhuni mbështetësja miqësore e një nëne emigrante" bashkon nënat finlandeze me nënat emigrante duke u mundësuar të kalojnë kohë së bashku dhe të fitojnë njohuri në lidhje me zakonet dhe gjuhën e secilës palë. Një mbështetëse miqësore mund të ofrojë këshilla praktike për çështjet e jetës së përditshme, si p.sh. sjelljen me zyrtarët e ndryshëm.

Angazhohuni dhe bëhuni mbështetëse miqësore!

## Gjyshërit e përbashkët

Ekipi i gjyshërve të përbashkët të MLL është i përbërë nga të rritur që duan të punojnë vullnetarisht në kohën e tyre të lirë dhe të realizojnë aktivitete me fëmijët. Gjyshërit e përbashkët për shembull, mund të vizitojnë kafenetë familjare të MLL për të lexuar histori, për të luajtur dhe për të bërë punëdore me fëmijët.

Bëhuni një gjysh i përbashkët!



C: Elias Lahtinen

## Evenimente

MLL është aktive në organizimin e evenimenteve dhe ngjarjeve për të gjithë familjen. MLL organizon edhe leksione lidhur me mirëqenien e fëmijës, prindërve dhe punën si prind.

Ejani të merrni informacion të përditësuar ose për ndihmuar në organizimin e një evenimenti!





## Bëhuni vullnetar

Vullnetarizëm do të thotë kur ju falni një pjesë të kohës tuaj për të punuar pa pagesë, për të ndihmuar të tjerët. Vullnetarizmi të shpërblen me ndjesinë e mirë se mund të ndryshosh diçka. Vullnetarizmi është gjithashtu një mënyrë për të takuar njerëz të rinj dhe për të fituar përvoja të reja.

Në MLL, të gjithë vullnetarët kanë marrë trajnimin dhe mbështetjen e duhur për rolin e tyre, për shembull si instruktor për një klub apo një grup.

Ju mund të kryeni aktivitet vullnetar për MLL, edhe nëse finlandishtja juaj nuk është e përsosur. Vullnetarizmi është në fakt një mundësi e shkëlqyer për të mësuar gjuhën. Ne disponojmë një gamë të gjerë mundësish vullnetarizmi të cilat mund të përshtaten me orarin tuaj dhe interesat personale.

### **Liga Mannerheim për Mirëqenien e Fëmijës ofron shumë lloje mundësish vullnetare:**

- Instruktor i Kafenesë familjare
- Instruktori i Klubit
- Vullnetar në mbështetje të familjeve
- Mbështetës miqësor për fëmijët ose të rinjtë
- Instruktor aktivitetesh baba-fëmijë
- Instruktor i Grupit të të barabartëve
- Gjysh i përbashkët
- Mbështetëse miqësore për emigrantet
- Vullnetar për evenimentet

## Kujdes për fëmijët

Liga Mannerheim për Mirëqenien e Fëmijës trajnon dhe siguron dado fëmijësh për familjet me fëmijë. Shërbimi MLL për kujdesin për fëmijët është konceptuar për të plotësuar nevojat e përkohshme dhe afatshkurtra për ndihmë të kujdesit për fëmijët.

Shërbimi fokusohet te prindërit të cilët për shembull kanë nevojë të udhëtojnë për arsye pune apo që kanë nevojë për një pauzë në mënyrë që të kalojnë pak kohë së bashku. Dadot e fëmijëve janë të disponueshme për të gjitha oraret. Pagesa është 10€ për orë, të dielave 20€ për orë.



Rezervo një dado për fëmijë

tel. +358 2 235 4720

<http://lastenhoito.mll.fi>

E hapur gjatë ditëve të javës nga  
08:00-13:00

C: Anna Autio



## Si mund të angazhohem?

Ejani dhe na vizitoni në  
Zyrën e Qarkut, stafi ynë  
është këtu për t'ju  
ndihmuar.



Pirkkakatu 2  
96200 Rovaniemi  
Tel. +358 50 465 0704

<http://lapinpiiri.mll.fi>  
<http://www.mll.fi>



*Liga Mannerheim për Mirëqenien e Fëmijës (MLL)  
është një OJF me anëtarësim të lirë që fokusohet në  
promovimin e mirëqenies së fëmijëve, të rinjve dhe  
familjeve me fëmijë.*

**MLL i fton të gjithë që të angazhohen!**

Pirkkakatu 2  
96200 Rovaniemi  
Tel. +358 50 465 0704

<http://lapinpiiri.mll.fi>  
<http://www.mll.fi>